

VENDIM
Nr. 61, datë 29.1.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABËLL 20 kV, V4, V5 DHE
KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i fiderave me kabëll 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “pemëtores” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 893 636 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 893 636 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike *GROUP* sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Nr.	Nr. i shtyllës	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM “ARË”/ TRUALL			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME <i>(Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj.)</i>
		Emër	Atësia	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	K2/V4	Luan	Hysni	Mërkuri	Valias	1649	18/1	Arë	4200	1	41	24	5455	130920	130920	
2	K3/V4	Lek	Pjeter		Kamzë	2066	36/10/2	Arë	3500	89	60	24	5455	130920	130920	
3	K5/V4	Admir	Llesh	Lleshi	Valias	1649	20/19	Arë	2283	7	158	24	5455	130920	130920	
4	K9/V4	Agim	Qerim	Muka	Laknas	2372	140/1	Arë	6120	1	229	24	5455	130920	130920	
5	K10/V4	Dude Edeva Erza Luljeta Denada Eni	Muharrem Hamit Hamit Hamit Izmir Izmir	Doku Doku Doku Doku Doku	Laknas	2372	140/22	Arë	838	2	208	24	5455	130920	130920	
6	K14/V4	Destan	Arif	Bruka	Vorë	1514	342/16	Arë	5544	1	240	28	717	20076	20076	
7	K15/V4	Xhil	Shaban	Keqa	Domje	1514	380/19	Arë	4566	2	13	24	717	17208	17208	
8	K15'/V4	Lufti	Kurtish	Kotarja	Domje	1514	380/91	Arë	500	10	18	24	717	17208	17208	
9	K16/V4	Azem	Sali	Uka	Laknas	2372	76/20	Arë	4800	1	193	28	717	20076	20076	
10	K17/V4	Xhemal	Dilaver	Burreli	Laknas	2372	249/2	Arë	6150	3	13	24	5455	130920	130920	
11	K18/V4	Fadil	Bajram	Shahini	Domje	1514	332/77	Arë	4455	8	33	24	717	17208	17208	
12	K20/V4	Bajram Gjyljje Fazile Xhemal Ylber Urime Firdeus Manushaqe Farudin	Xhemali Osman Tahir Mehmet Mehmet Mehmet Faik Xhemal Mehmet Mehmet	Kotarja Kotarja Kotarja Kotarja Kotarja Kotarja Kotarja Kotarja	Domje	1514	324/8/1	Arë	5518	1	117	24	717	17208	17208	
13	K21/V4	Agim	Elez	Ferati	Laknas	2372	242/23	Arë	2000	13	46	24	5455	130920	130920	
14	K22/V4	Ymer	Mehdi	Shkurti	Domje	1514	320/14	Arë	5188	1	87	24	717	17208	17208	
15	K23/V4	Musli	Mehmet	Lala	Laknas	2372	240/30	Arë	1500	10	40	24	5455	130920	130920	
16	K2/V5	Muharrem		Pllumbi	Cekrez	1377	430/4	Arë	2140	1	23	28	1822	51016	51016	
17	K3/V5	Votim	Kurt	Topalli	Cerkez	1377	418/21	Arë	1200	12	246	24	1822	43728	43728	
18	K5/V5	Astrit	Zef	Dogi	Dritas	1549	456/15	Arë	2000	8	93	24	1822	43728	43728	
19	K6/V5	Festim	Hamdi	Gjorllaku	Dritas	1549	499/16	Pemëtore	4300	6	157	28	1822	51016	51016	
20	K7/V5	Dalip	Ismail	Dalti	Cekrez	1377	608/4	Pemëtore	2800	5	216	24	1822	43728	43728	
21	K8/V5	Halil	Avdyll	Muca	Dritas	1549	468/26	Arë	2497	5	187	24	595	14280	14280	
22	K11/V5	Dashamir	Osman	Korbi	Cekrez	1377	468/32	Arë	860	14	73	24	1822	43728	43728	
23	K13/V5	Asllan	Xhemal	Maloku	Cekrez	1377	357/1	Arë	14100	4	195	24	595	14280	14280	
24	K14/V5	Lulzim	Avdyll	Ago	Kamzë	2066	134/18	Arë	4200	5	118	24	5455	130920	130920	
25	K15/V5	ALB INVESTA 33			Kamzë	2066	343/5	Truall	20000	49	167	28	5455	152740	152740	
26	K16/V5	Nazife	Dalip	Hoxha	Kamzë	2066	136/20	Arë	4200	1	175	24	5455	130920	130920	
VLERA TOTALE															1893636	